

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRËN

Nr. / Br. 57583/25

Nr. i fq. / Br. st. - 2 -

Data: / Datum: 03. 11. 25

VUSHTERRI - VUÇITRËN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrië
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 143/25, 30.10/2025

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 24 shtator 2025 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:40.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: Zdravko Zdravkoviç (kryesues), Kushtrim Hyseni, Behar Duraku, Gresa Muli, Berat Maloku, Zana Krasniç Saraçi, Aziz Emmini, Adem Hoti dhe Zojë Hajrizi, anëtarë të komitetit.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: përfaqësues të KFOR-it sloven, OSBE-së, UNMIK, Aktere Dërvari - përkthyes, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Zdravko Zdravkoviç, kryesues i Komitetit për Komunitete, i cili konstatoi se ekziston shumica për punë.

Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Diskutim i hapur për çështje sociale;
3. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

2. Diskutim i hapur për çështje sociale.

Zdravko Zdravkoviç, kryesues i komitetit – Tha se janë disa familje me gjendje të vështirë ekonomike, që mundohemi maksimalisht t'i ndihmojmë. E kemi diskutuar edhe në mbledhjet e kaluara se në komunitetin tim ka raste që janë edhe të sëmurë mental. Po bëjmë përpjekje që t'i ndihmojmë aq sa mundemi. Përveç rasteve sociale, një problem tjetër është ndërrimi i numrave të rrugëve dhe adresave të vendbanimeve (përditësime).

Berat Maloku, anëtar i komitetit – deklaroi se jam anëtar në KKZ dhe si informacion e kemi që ky problem rregullohet edhe përmes E-Kosovës.

Zdravko Zdravkoviç, kryesues i komitetit – po ka raste që E-Kosova nuk po funksionon.

Berat Maloku, anëtar i komitetit – ndoshta ka raste që nuk funksionon E-Kosova për shkak të ngarkesës, por është duke funksionuar.

3. Të ndryshme.

Zdravko Zdravkoviç, kryesues i komitetit – besoj se takimin e radhës do ta mbajmë si zakonisht në fund të muajit tetor. Jemi në prag të zgjedhjeve, shpresojmë që do të fitojnë më të mirët.

Mbledhja përfundoi në ora 11:05.

Bujar Klinaku

Procesmbajtës



Zdravko Zdravkoviç

Kryesues i K. për Komunitete